



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 212, datë 25.11.2021

**PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 17, DATË 21.03.2007
“PËR MBAJTJEN DHE RUAJTJEN E REGJISTRAVE TË SUBJEKTEVE TË
LICENCUARA, AUTORIZUARA DHE MIRATUARA NGA AUTORITETI I
MBIKËQYRJES FINANCIARE”, E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të Ligjit 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 17, datë 21.03.2007 “Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuara dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.**
- 2. Ngarkohen Departamentet përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**

Në rregulloren nr. 17, datë 21.03.2007 “Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuar dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 2, pika 1, pas fjalëve “Për fondet e pensionit vullnetar”, shtohen fjalët “dhe nenin 22 të Ligjit 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.
2. Në nenin 4, pika 1, pas fjalëve “Regjistri për subjektet që publikojnë analiza financiare në fushën e letrave me vlerë”, shtohen fjalët e mëposhtme:
 - a. Regjistër për agentët e tokenit digjital;
 - b. Regjistër i bursave të licencuara DLT;
 - c. Regjistri i Kujdestarëve të Portofolit të Palëve të Treta.
3. Në nenin 7, pika 1, pas fjalëve “paraqitjes së informacionit”, shtohen fjalët “ose nga data e njoftimit të titullarit të licencës”.
4. Pas nenit 21/1, shtohet neni 21/2, me këtë përmbajtje:

Neni 21/2

Të dhëna për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë

1. Në regjistrin e shoqërive që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, do të shënohen:
 - a. Statusi i licencimit;
 - b. Për Bursat DLT duhet të specifikohet nëse bursa DLT ka një licencë të kategorisë “A”, “B”, ose “C”;
 - c. Numrin e protokollit/eve dhe data/at e vendimeve të marra nga autoriteti përgjegjës që ka lëshuar licencën përkatëse;
 - d. Emrin e personit juridik;
 - e. Forma ligjore e organizimit të shoqërisë;
 - f. Numri i identifikimit të shoqërisë;
 - g. Selia qendrore;
 - h. Adresa zyrtare e e-mail-it të agentit TD (nëse aplikohet) dhe të titullarit të licencës;
 - i. Referimin e çdo vendimi tek autoritetet përgjegjëse, nëpërmjet të cilit këto autoritete kanë ndërmarrë sanksione ndaj titullarit të licencës, në përputhje me këtë ligj;
 - j. Konfirmimin e marrjes në kohë të deklaratës së përputhshmërisë të titullarit të licencës (nëse aplikohet);
 - k. Personin e kontaktit.
2. Çdo regjistër i parashikuar në këtë nen, do të përditësohet rregullisht dhe në çdo rast, të paktën çdo 12 muaj.

5. Pas nenit 24, shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

Neni 24/1

Shënimi për licencë të kufizuar të agjentit TD

Në regjistrin e agjentëve të tokenit digjital, do të shënohet nëse subjekti kërkues aplikon për një licencë të kufizuar të agjentët TD në përputhje me rregulloren për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digjital.